

PACEP II

"Mbështetje për Parlamentin dhe Shoqërinë Civile" PACEP II është një projekt i Qeverisë Zvicerane i zbatuar nga Global Partners Governance Albania, që synon të mbështesë dhe fuqizojë mbikëqyrjen parlamentare. Ky projekt me kohëzgjatje 4 vjeçare (2024–2028) vjen në vazhden e përpjekjeve më të gjera për të mbështetur zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

Zbatimi i PACEP II ngrihet mbi disa shtylla:

Fuqizimi i ekosistemit të mbikëqyrjes në Shqipëri

Projekti synon të rrisë efektivitetin e mbikëqyrjes parlamentare duke mbështetur njëkohësisht të gjithë aktorët kryesorë: (i) Kuvendin e Shqipërisë, (ii) institucionet e pavarura dhe (iii) organizatat e shoqërisë civile përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe krijimit të mundësive e incentivave për bashkëpunim.

Kuvendi	Institucionet e Pavarura	Shoqëria Civile
<p>Përmirësimi i Procedurave Parlamentare dhe Ngritja e Kapaciteteve të Stafit Administrativ: Projekti do të punojë drejtpërdrejtë me Komisionet Parlamentare dhe stafin administrativ për të përmirësuar planifikimin dhe aftësitë analitike, duke synuar kështu një mbikëqyrje sa më efikase dhe të bazuar në evidenca.</p>	<p>Fuqizimi i Institucioneve të Pavarura: Projekti synon të përmirësojë aftësitë e institucioneve të pavarura për të ofruar rekomandime të zbatueshme dhe të matshme përmes standarteve të reja, cilësore të raportimit, dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit.</p>	<p>Fuqizimi i Zërit të Shoqërisë Civile: Projekti kërkon të rrisë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset legjislative dhe të mbikëqyrjes nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe krijimit të platformave të angazhimit, duke siguruar që shqetësimet e qytetarëve të përfaqësohen në mënyrë efektive.</p>

Nxitja e Bashkëpunimit

Duke e parë bashkëpunimin mes palëve si një aspekt thelbësor të procesit të mbikëqyrjes, projekti synon të krijojë incentiva dhe hapësira për shkëmbim dhe komunikim të ndërsjellë mes Kuvendit, institucioneve të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Support to Parliament and Civil Society (PACEP II) is a project of the Swiss Development Cooperation implemented by Global Partners Governance in Albania.



Global Partners
Governance